



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:317857

Datë: 20.11.2024

Numri i dokumentit: 06482538

P.nr.673/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Rashkaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sefedin Avdijaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. Gj. nga fshati . . ., Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën-par.1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.565/2024 të datës 06.11.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, me datë 20.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.565/2024 të datës 06.11.2024.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 495, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari,

A. GJ., nga i ati M dhe e ëma N, e gjinisë E, data e lindjes . . ., në Gjakovë, ku banon, në fsh. . ., Komuna e Deçanit, me profesion Infermier, i fejuar, ka të kryer Bachelor, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal. . ., shqiptar, shtetas i Republikës të Kosovës, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse, me dt.15.05.2024, rreth orës:18:20 min, në rrugën Nëna Terezë, në Gjakovë, tek parkingu afër ëmbëltores Sharri, i pandehuri me dashje i shkakton lëndim të lehtë trupor këtu të dëmtuarit B.L. nga Gjakova, në të mënyrë që ditën kritike, derisa sa i dëmtuari ishte duke punuar në parking, i pandehuri me veturën e tij të tipit . . .me targa . . .parkohet dhe zbret nga vetura dhe fillon të fjaloset me të dëmtuarin dhe duke i thënë “Ti ma ke nguc gruan a” dhe në fjalosje e

sipër e godet me shuplak në fytyrë dhe grushte në pjesë të ndryshme të trupit, me ç'rast edhe i shkaktonte lëndim të lehtë truporë me pasoja të përkohshme për shëndetin dhe atë ndrydhje të indeve të buta të regjionit tëmth or të anës së majtë të kokës dhe gërvishtje lëkurure mes gishtit të 1-rë dhe 2-të (gishti i madh tregues)të shuplakës së dorës së majtë, më përafërsisht të përshkruara si në Akt Ekspertizën Mjekoligjore të Dr. F. D.të datës 19.10.2024.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim të lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën-par.1.4 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në kuptim të neneve 4, 38, 40 par.1 pika 1.3, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit A. Gj. në shumë prej katërqind (400) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditësh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditësh, duke llogaritur çdo njëzet (20) Euro me një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari, që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë:

- në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) Euro dhe
- për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) Euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

I dëmtuari B.L. nga Gjakova, rruga "Ilir Soba", p.nr., udhëzohet që kërkesën pasurore ta realizojë në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.565/2024 të datës 06.11.2024, kundër të akuzuarit A. Gj. nga fshati . . . , Komuna e Deçanit, për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën-par.1.4 të KPRK-së, Po ashtu me aktakuzën e lartcekur Gjykatës i ka propozuar që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të marr aktgjykim me të cilin do t'i shqiptoj të akuzuarit dënim me gjobë, pasi që konsideron se ekzistojnë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe mori vendim që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, si:

- Raporti i oficerit policor A.B, KPS#11108 me nr.2024-EA-668, i dt.15.05.2024;
- Deklaratat e të dëmtuarit B.L. të dhënë në polici më dt.15.05.2024;
- Deklarata e të pandehurit A. Gj. e dhënë në polici më dt. 15.05.2024;
- Akt ekspertiza mjeko ligjore e dr. F. D.e datës 19.10.2024
- CD-ja;
- Foto-Dokumentacioni, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjykata, duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.1, nën-par.1.4 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Andaj, duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata është e mendimit se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë në tërësi do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, u mor konform nenit 449 paragrafi 1 dhe 2, nënpar.2.6. dhe 2.9., lidhur me nenin 452 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 36 paragrafi 3, nën-par. 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.673/2024 me datë 20.11.2024

Bashkëpunëtori profesional,

Sefedin Avdijaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Ilir I. Rashkaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej tetë (8) ditëve, nga pranimi i të njëjtit. Pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.